

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Korçë

PROGRAMI
I KURSIT TË VEÇANTË
“RIPARIM CELULARËSH”

Kodi: RC-19

Miratoi

DREJTOR

.....

Korçë, 2019

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“RIPARIM CELULARËSH”

(RC- 19)

I. Profili profesional i riparuesit të celularëve.

a) Karakteristikat e riparuesit të celularëve.

Riparuesi i celularëve është i aftë të kryejë **detyra** profesionale si i punësuar në biznese që ofrojnë shërbime riparimi celularësh.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, riparuesi i celularëve duhet që të zotërojë **njohuri** profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë të riparimit të celularëve, si dhe **shprehje** profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të riparimit të celularëve.

Suksesi i riparuesit të celularëve është i lidhur ngushtë dhe me **sjellje** (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, përkujdesja, komunikimi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e riparuesit të celularëve.

Profesioni i riparimit të celularëve është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për, zëvendësim komponentësh nga bordi i celularëve, programim, formatim, si dhe organizimi i punës. Ai mund të punësohet në servise të ndryshme të pajisjeve elektronike, servise celularësh, si ndihmes për të ofruar këto shërbime.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë duke u vetëpunësuar në riparimin e pajisjeve të ndryshme elektronike. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale të elektronikës apo trajnimit nëpërmjet punës, një riparues celularësh mund të marrë disa njohuri shtesë për riparimin e kompjuterave.

Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e servisit të celularëve, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: riparues pajisjesh elektronike, etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të kursit për riparim celularësh.

Në përfundim të Kursit për riparim celularësh, kursantët do të jenë të aftë të:

- përgatisin vendin e punës në servis;
- përzgjedhin mjetet dhe materialet e punës;
- përdorin dhe mirëmbajnë mjetet e punës;
- kryejnë llogaritje ekonomike dhe veprime për pagesat;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike;
- zbatojnë rregullat e higjienës personale dhe të vendit të punës;
- zbatojnë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

- hulumtojnë / kërkojnë informacion në burime të ndryshme në formë fizike ose elektronike;
- përdorin tutoriale të ndryshme për teknika të reja për riparimin e celularëve;
- kryejnë zëvendësimin e ekraneve të celularëve;
- kryejnë zëvendësimin e bazave të karrikimit;
- kryejnë zëvendësimin e mikroelementeve;
- kryejnë formatimin e celularëve;
- kryejnë programimin e celularëve;
- presin klientin në vendin e punës;
- komunikojnë me etikë profesionale;
- ofrojnë këshilla për klientët.

III. Kërkesat e pranimit në kursin e riparim celularësh.

Pjesëmarrësit në kursin për Riparim celularësh, duhet të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e mesëm të detyruar.

IV. Kohëzgjatja e kursit për riparim celularësh

420 orë mësimore, ku:

1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e kursit për riparim celularësh

Nr	Titulli i modulit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet mësimore
1	Hyrje në profesionin e riparimit të celularëve.	RC-01- 19	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1- Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Riparimit të celularëve. 2- Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparuesit të celularëve. 3- Kursanti përshkruan rregullat e etikës, komunikimit, higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në servis. 4- Kursanti përshkruan llojet e celularëve dhe karakteristikat e llojeve të ndryshme të celularëve.

2	Komponentët kryesorë të celularëve dhe zëvendësimi i tyre.	RC-02-19	190 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktike 10% Vlerësim	1- Kursanti realizon zëvendësimin e ekraneve të celularëve. 2- Kursanti realizon ndërrimin e xhamave të ekraneve me xhel. 3- Kursanti realizon zëvendësimin e bokseve dhe mikrofonave. 4- Kursanti realizon zëvendësimin e bazave të karikimit. 5- Kursanti realizon zëvendësimin e mikroelementeve në bord. 6- Kursanti realizon assemblimin e celularëve të ndryshëm.
3	Programimi dhe formatimi i celularëve.	RC-03-19	180 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësim	1- Kursanti përshkruan mënyrat e formatimit dhe programimit për celularë të ndryshëm. 2- Kursanti dallon defektet në programet e celularëve. 3- Kursanti realizon formatimin e celularëve. 4- Kursanti realizon programimin e celularëve. 5- Kursanti realizon çkodimin e celularëve. 6- Kursanti realizon riparimin e certifikatave të celularëve.
4	Organizimi i punës. Ngritja e një servisi celularësh.	RC-04-19	30 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktike 10% Vlerësim	1- Kursanti përshkruan hapat për ngritjen e një biznesi. 2- Kursanti ushtrohet rreth administrimit të një biznesi të ri. 3- Kursanti përshkruan rëndësinë e marrëdhënies me klientin.

VI. Vlerësimi dhe certifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha rezultatet mësimore (RM-të) që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko – praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko – praktik, kursantët fitojnë certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruesit e moduleve të kursit për riparim celularësh:

1. Moduli “Hyrje në profesionin e riparimit të celularëve”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	HYRJE NE PROFESIONIN E RIPARIMIT TË CELULARËVE.	RC-01-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të riparimit të celularëve, me mjedisin dhe mjetet e punës së riparuesit të celularëve, me rregullat e etikës, higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në punë, si dhe me llojet dhe karakteristikat e celularëve të ndryshëm.	
Kohëzgjatja e modulit	20 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë të detyruar, të jenë mbi 18 vjeç.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të Riparimit të celularëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të riparim celularëve për klientin; - të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së riparuesit të celularëve; - të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së riparuesit të celularëve; - të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor riparuesi i celularëve; - të përshkruajë proceset kryesore të veprimtarisë së riparuesit të celularëve; - të tregojë organizimin e punës servis; - të përshkruajë kërkesat profesionale për riparuesin e celularëve; - të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të riparuesit të celularëve; - të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së riparuesit të celularëve; - të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit të celularëve; - të përshkruajë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë.	

-
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së riparuesit të celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjedisin e punës në një servis;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës së riparuesit të celularëve;
- të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së riparuesit të celularëve;
- të përshkruajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së riparuesit të celularëve;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të punës së riparuesit të celularëve;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së riparuesit të celularëve;
- të dallojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e riparuesit të celularëve;
- të përshkruajë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e riparuesit të celularëve;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit për materialet e punës së riparuesit të celularëve;
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së riparuesit të celularëve;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë / shkrim.
- Vlerësim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, komunikimit, higjienës, të sigurtisë dhe të mbrojtjes së mjedisit në servis.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve në servis;
- të dallojë tipet e ndryshme të klientëve;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientët, eprorët, kolegët etj;
- të përshkruajë rregullat e higjienës personale.
- të zbatojë rregullat e higjienës personale.
- të përshkruajë rregullat e higjienës së klientit, mjedisit dhe mjeteve të punës;

- të zbatojë rregullat e sigurisë së klientit dhe të mjedisit të punës;
- të përshkruajë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të riparimit të celularëve;
- të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të riparimit të celularëve;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit.
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit të punës në servis.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë / shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përshkruan llojet dhe karakteristikat e llojeve të ndryshme të celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të celularëve të ndryshëm.
- të tregojë mënyrën e funksionimit të modeleve të ndryshme të celularëve.
- të përshkruajë parametrat e llojeve të ndryshme të celularëve.
- të tregojë ndryshimet që kanë pësuar telefonat celularë në vite.
- të zbatojë rregullat e higjenës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë / shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së servisit të riparimit të celularëve. Rekomandohen vizita në biznese që kryejnë veprimtari të riparimit të celularëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në servis. Atyre duhet ti jepen detyra praktike të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e riparuesit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Rekomandohet të përdoret simulimi apo lojë me role. Kursantët

	duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës, servis, ku ofrohen shërbimet. - Celularë. - Komploti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në servis e riparimit të celularëve. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzues, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

2. Moduli “Komponentët kryesorë të celularëve dhe zëvendësimi i tyre”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	KOMPONENTËT KRYESORË TË CELULARËVE DHE ZËVËNDËSIMI I TYRE.	RC-02-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë dhe komponentët kryesorë të celularëve si dhe i aftëson ata të përshkruajnë dhe zëvendësojnë komponentët e ndryshëm të celularëve.	
Kohëzgjatja e modulit	190 orë mësimore Rekomandohet: 20% Teori; 70% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e lartë të detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparimit të celularëve.”	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti realizon zëvendësimin e ekraneve të celularëve. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë mënyrat e formatimit për celularë të ndryshëm; - të përshkruajë llojet e ndryshme të ekraneve të celularëve; - të përshkruajë mënyrën e ndërtimit të ekraneve të celularëve; - të identifikojë defektet e ndryshme të ekraneve;	

-
- të analizojë faktorët që ndikojnë në shkatimin e defekteve të ndryshme në ekran;
 - të realizojë zëvendësimin e ekraneve në celularë të ndryshëm;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti realizon ndërrimin e xhamave të ekraneve me xhel.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë llojin e ekranit me xhel;
- të analizojë karakteristikat e ekranit para heqjes të xhamit;
- të përzgjedhë modelin e ngjitësit në varësi të ekranit;
- të realizojë zëvendësimin e filtrit polarizues të ekranit;
- të realizojë ngjitjen e xhamit me xhel;
- të realizojë ngjitjen e xhamit me vakum;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti realizon zëvendësimin e bokseve dhe mikrofonave.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e ndryshme të bokseve të celularëve;
- të identifikojë defekte të ndryshme në bosket e celularëve;
- të analizojë shkaqet e defekteve të bokseve;
- të realizojë zëvendësimin e bokseve të celularëve;
- të përshkruajë llojet e ndryshme të mikrofonave të celularëve;
- të identifikojë defekte të ndryshme në mikrofonat e celularëve;
- të realizojë zëvendësimin e mikrofonave në celularë;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti përshkruan mënyrën e zëvendësimit të bazave të karikimit.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e ndryshme të bazave të karikimit;
- të identifikojë defekte të ndryshme të bazave të karikimit;

- të analizojë shkaqët e defekteve të bazave të karikimit;
- të përzgjedhë modelin e duhur të bazave të karikimit në celularë të ndryshëm;
- të realizojë zëvendësimin e bazave të karikimit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 5 Kursanti realizon zëvendësimin e mikroelementeve në bord.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë llojet e ndryshme të mikroelementeve;
- të identifikojë defektet e ndryshme të mikroelementeve;
- të analizojë shkaqet e defekteve të mikroelementeve;
- të përzgjedhë mikroelementin e duhur në celularë të ndryshëm;
- të realizojë zëvendësimin e mikroelementeve;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti realizon assemblimin e celularëve të ndryshëm.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të identifikojë pjesët përbërëse të celularëve të ndryshëm;
- të njohë mënyrën e vendosjes të pjesëve në celularë të ndryshëm;
- të përzgjedhë pjesët e duhura për celularë të ndryshëm;
- të realizojë assemblimin e celularëve të ndryshëm;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së servisit të riparimit të celularëve. Rekomandohen vizita në biznese që kryejnë veprimtari të riparimit të celularëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në servis. Atyre duhet ti jepen detyra praktike të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku

	mbështetet puna e riparuesit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. - Rekomandohet të përdoret simulimi apo lojë me role. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. - Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul. - Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.
Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit	Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme: - Klasë mësimore e pajisur me mjete, celularë dhe materiale pamore. - Mjedise reale të punës, servis, ku ofrohen shërbimet. - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në servisin e riparimit të celularëve. - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

3. Moduli “Programimi dhe formatimi i celularëve”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PROGRAMIMI DHE FORMATIMI I CELULARËVE	RC-03-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me programimin dhe formatimin e celularëve, si dhe i aftëson ata të përzgjedhin programin në bazë të komponentëve të celularit.	
Kohëzgjatja e modulit	180 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime.	
Niveli i parapëlqyer për zbatim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e riparimit të celularëve” dhe “Komponentët kryesorë të celularëve dhe zëvendësimi i tyre”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan mënyrat e formatimit dhe programimit për celularë të ndryshëm. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë:	

-
- të përshkruajë mënyrat e formatimit për celularë të ndryshëm;
 - të përshkruajë mënyrën e programimit të celularëve të ndryshëm;
 - të identifikojë programet e ndryshme të formatimit;
 - të identifikojë programet e ndryshme të programimit;
 - të përzgjedhë box-et e ndryshme të formatimit dhe programimit për celularë të ndryshëm;
 - të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 2 Kursanti dallon defektet në programet e celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të analizojë mënyrën e funksionimit të programeve të ndryshme të celularëve;
- të identifikojë defekte të ndryshme në programet e celularëve;
- të analizojë shkaqet e defekteve të programit;
- të identifikojë viruset e ndryshme në programet e celularëve;
- të dallojë defektet e programit nga ato të komponentëve të tjerë;
- të dallojë rastet e formatimit nga ato të programimit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje – përgjigje me gojë / shkrim.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 3 Kursanti realizon formatimin e celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mënyrat e formatimit të celularëve të ndryshëm;
- të identifikojë programet e ndryshme të formatimit të celularëve;
- të përzgjedhë programet e duhura për celularë të ndryshëm;
- të realizojë formatimin e celularëve të ndryshëm;
- të realizojë konfigurimet e nevojshme të celularëve të ndryshëm pas formatimit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.

- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 4 Kursanti realizon programimin e celularëve

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë modelet e box-eve sipas llojit të celularit;
- të identifikojë programin e përshtatshëm sipas modelit të celularit;
- të përzgjedhë programet e duhura për celularë të ndryshëm;
- të përzgjedhë opsionet në bazë të defektit;
- të dallojë problemet e ndryshme që hasen gjatë programimit;
- të realizojë programimin e celularëve të ndryshëm;
- të realizojë konfigurimet e nevojshme të celularëve të ndryshëm pas programimit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 5 Kursanti realizon çkodimin e celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë modelet e box-eve sipas llojit të celularit;
- të identifikojë llojin e kodit të celularit;
- të përzgjedhë programet e duhura për celularë të ndryshëm;
- të përzgjedhë opsionet në bazë të kodit të celularit;
- të dallojë problemet e ndryshme që hasen gjatë çkodimit;
- të realizojë çkodimin e kodit të rrjetit;
- të realizojë çkodimin e kodit personal;
- të realizojë çkodimin FRP.
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

RM 6 Kursanti realizon riparimin e certifikatave të celularëve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përzgjedhë modelet e box - eve sipas llojit të celularit;
- të identifikojë llojin e certifikatës të demtuar të celularit;

- të përzgjedhë programet e duhura për celularë të ndryshëm;
- të përzgjedhë opsionet në bazë të çertifikatës të dëmtuar;
- të dallojë problemet e ndryshme që hasen gjatë riparimit të çertifikatave;
- të realizojë riparimin e çertifikatave të ndryshme;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së servisit të riparimit të celularëve. Rekomandohen vizita në biznese që kryejnë veprimtari të riparimit të celularëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në servis. Atyre duhet ti jepen detyra praktike të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e riparuesit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Rekomandohet të përdoret simulimi apo lojë me role. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- ***Kujdes:*** Nuk lejohet modifikimi i çertifikatave të celularëve por vetëm riparimi i tyre. Modifikimi i çertifikatave apo numrit të IMEI-t denohet me ligj.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës, servis, ku ofrohen shërbimet.
 - Celularë.
 - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në servisin e riparimit të celularëve.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

4. Moduli “Organizimi i punës, ngritja e një servisi celularësh”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	ORGANIZIMI I PUNËS. NGRITJA E NJË SERVISI CELULARËSH.	RC-04-19
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me organizimin e punës në një servis celularësh si dhe me organizimin.	
Kohëzgjatja e modulit	30 orë mësimore Rekomandohet: 30% Teori; 60% Praktikë; 10% Vlerësime	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm të detyruar, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e riparimit të celularëve”, “Komponentët kryesorë të celularëve dhe zëvendësimi i tyre” dhe “Programimi dhe formatimi i celularëve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Kursanti përshkruan hapat për ngritjen e një biznesi. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të njohë legjislacionin e punës; - të njohë të drejtat dhe detyrat si sipërmarrës; - të njohë të drejtat dhe detyrat e punonjësve; - të identifikojë furnitorët kryesorë për servisin e celularëve; - të pershtatë mjedisin e punës sipas nevojave; - të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: - Pyetje - përgjigje me gojë. - Pyetje - përgjigje me shkrim. RM 2 Kursanti ushtrohet rreth administrimit të një biznesi të ri. Kriteret e vlerësimit: Kursanti duhet të jetë i aftë: - të analizojë pikat e forta dhe të dobëta të biznesit të tij; - të identifikojë pajisjet më të nevojshme për hapjen e një biznesi servis celularësh; - të përzgjedhë pjesët e kembimit më të nevojshme duke marrë parasysh vendndodhjen e biznesit; - të realizojë inventarin në një servis celularësh; - të njohë kostot dhe fitimin e një servisi celularësh;	

- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

RM 3 Kursanti përshkruan rëndësinë e marrëdhënies me klientin.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mënyrat e komunikimit me klientin;
- të kuptojë problemin e klientit;
- të japë zgjidhjen e drejtë të problemit të klientit;
- të zbatojë rregullat e higjienës, mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së servisit të riparimit të celularëve. Rekomandohen vizita në biznese që kryejnë veprimtari të riparimit të celularëve.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në servis. Atyre duhet ti jepen detyra praktike të ndryshme që të vëzhgojnë dhe analizojnë mjedisin, mjetet dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e riparuesit, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur.
- Rekomandohet të përdoret simulimi apo lojë me role. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Mjedisë reale të punës, servis, ku ofrohen shërbimet.
 - Celularë.

-
- Kompleti i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në servisën e riparimit të celularëve.
 - Katalogë, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-